



**Republika e Kosovës**  
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Agjencia e Kosovës për Akreditim  
Agencija Kosova za Akreditaciju  
Kosovo Accreditation Agency

Data: 06.07.2017

Ref.: 532/17

Në mbështetje të nenit 4, dhe 23, të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr.03/L-189, datë 16.09.2010), neni 7, dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.20/2016, datë 20.09.2016), Këshilli Shtetërorë i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 51-të, të mbajtur më 23 Qershor 2017, mori:

**V E N D I M**

- I. Riakreditohet Universiteti i Gjilanit “Kadri Zeka” në nivel institucional për periudhën tre vjeçare, 1 tetor 2017 – 30 shtator 2020.
- II. Riakreditohen programet e studimit të Universitetit të Gjilanit “Kadri Zeka” për periudhën tre vjeçare, 1 tetor 2017 – 30 shtator 2020:
  - Banka, Financa dhe Kontabilitet, BSc, 180 ECTS, maksimumi 200 studentë për vit akademik;
  - Marketing, BSc, 180 ECTS, maksimumi 100 studentë për vit akademik.
- III. Akreditohen programet e studimit të Universitetit të Gjilanit “Kadri Zeka” për periudhën tre vjeçare, 1 tetor 2017 – 30 shtator 2020:
  - E-Qeverisja, MSc, 120 ECTS, maksimumi 50 studentë për vit akademik;
  - Qeverisja Lokale dhe Shoqëria Demokratike, MSc, 120 ECTS, maksimumi 50 studentë për vit akademik.
- IV. Nuk akreditohet programi i studimit i Universitetit të Gjilanit “Kadri Zeka”:
  - Edukimi Special, MSc, 120 ECTS.
- V. Obligohet Universiteti i Gjilanit “Kadri Zeka” që deri me 1 tetor 2017 në Agjencinë e Kosovës për Akreditim (AKA) ta dorëzoj planin e rekrutimit të stafit akademik, për vitin akademik 2017/2018, për arsyeje të pensionimit të mundshëm të stafit, apo për çfarëdo arsyeje tjetër.

VI. Obligohet Universiteti i Gjilanit “Kadri Zeka” që deri me datë 1 dhjetor 2017 të dorëzoj në Agjencinë e Kosovës për Akreditim (AKA) Planin e Implementimit të Rekomandimeve të dhëna nga ekspertët ndërkombëtar të akreditimit.

VII. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

### Arsyetimi

Universiteti i Gjilanit “Kadri Zeka” ka parashtruar kërkesë pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA), për ri/akreditim institucional dhe të programeve të studimit: Banka, Financa dhe Kontabilitet, BSc, 180 ECTS, Marketing, BSc, 180 ECTS, E-Qeverisja, MSc, 120 ECTS, Qeverisja Lokale dhe Shoqëria Demokratike, MSc, 120 ECTS, dhe Edukimi Special, MSc, 120 ECTS me stafin akademik si në vijim:

Nr.	Programi i studimit	Niveli	ECTS	Bartësit e Programit
1	Banka, Financa dhe Kontabilitet	BSc	180	Arben Mustafa, Lutfi Zharku, dhe Urtak Hamiti
2	Marketing	BSc	180	Xhevat Sopi, Refik Kryeziu, dhe Musa Ajeti
3	E-Qeverisja	MSc	120	Artan Dermaku, Sadik Haxhiu, dhe Gezim Tosuni
4	Qeverisja Lokale dhe Shoqëria Demokratike	MSc	120	Dukagjin Leka, Vehbi Ramaj, dhe Armend Podvorica
5	Edukimi Special	MSc	120	Januz Dervodeli, Merxhan Avdyli, dhe Bashkim Dalipi

AKA ka organizuar vizitën në Universitetin e Gjilanit “Kadri Zeka” më 12.05.2017, me qëllim të vlerësimit të programeve të studimit të cekur me sipër me ekspertët ndërkombëtar të akreditimit me këtë përbërje: Milan Pol, Peter Parycek, Dietmar Paier, Frederic Mertens de Wilmars dhe Luca Ciubotaru.

Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC) në mbledhjen e mbajtur më 23 qershor 2017 ka shqyrtuar aplikacionin e Universitetit të Gjilanit “Kadri Zeka”, dhe duke u bazuar në të gjeturat e ekspertëve të akreditimit gjatë realizimit të vizitës, dhe në rekomandimet përfundimtare të dhëna në raportin final nga ekspertët e cekur më sipër, KSHC vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Për sa i përket programit të studimit Edukimi Special, MSc, raporti i ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit, numëron këto vërejtje kryesore të cilat kanë qar në mos dhënien e rekomandimit për akreditim:

Sipas ekspertëve ndërkombëtarë, stafi akademik për programin e propozuar është kritik, dhe ndoshta aspekti më problematik i programit të studimit. Në listën e stafit akademik të listuar në raportin e vet vlerësimit asnjëri nga ta nuk është i kualifikuar për Edukimi Special dhe vetëm dy anëtarë të stafit akademik me kontratë të rregullt kanë kualifikim nga shkencat e edukimit/ pedagogjisë. E gjithë pjesa tjetër e stafit

akademik kanë profil apo ekspertizë tjetër të cilat janë shumë të ndryshme nga programi i studimit. Për më tepër, në mesin e tre personave, bartës të programit të studimit, asnjëri nga ta nuk është i kualifikuar për Edukim Special, pasi që njëri nga ta është i profilizuar në Edukim/ Pedagogji, dhe dy të tjerët në Filologji dhe Fizikë. Ekspertët kanë deklaruar se sipas rregullave të AKA-së kjo është e pamjaftueshme.

**Këshillë juridike:** Kundër këtij vendimi mund të paraqitet kërkesë për rishqyrtim të vendimit sipas nenit 126, pika 2 a, të Ligjit mbi Procedurën Administrative nr. 02/L-28. Kërkesa për rishqyrtim të vendimit i dorëzohet Agjencinë e Kosovës për Akreditim në afatin prej 30 ditëve nga data e pranimit të këtij vendimi siç është përcaktuar në nenin 130, pika 1 e Ligjit mbi Procedurën Administrative.

Vendimi iu dërgohet:

- Universiteti i Gjilanit “Kadri Zeka”;
- MASHT;
- Arkivit të AKA-së.



---

Prof. Asoc. Dr. Blerim Rexha  
Kryetar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë